

Më
Dana

02. - 02. 2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Mustaf Tahiri, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna e Ferizajit, për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, P/II.nr.2313-6/17, e dt. 21.11.2017, duke vendosur lidhur me kërkesën e PTH-së në Ferizaj, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, më dt. 12.12.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-së në Ferizaj, P/II.nr.2313-6/17, e dt. 21.11.2017, dhe kjo gjykatë lëshon:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

[REDACTED], nga fshati [REDACTED] komuna Ferizaj, i lindur më [REDACTED] nga i ati [REDACTED] Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

S e p s e:

Me dt. 13.09.2017, rreth orës 17:16h, në vendin e quajtur "Te mrrizat Burrnikë", Regjioni Nerodime-Jezerc, Komuna e Ferizaj, me qëllim vjedhe, në pyllin e pronësisë shoqërore, me sharrë motorike ka prerë një (2) trungje druri të llojit të ahut, me diametër 40-45cm, në lartësi prej boniteti III, si dhe me vëllim të përgjithshëm prej 2.40 metër kub, të cilat i ka transportuar me traktor të markës Rakovicë, duke i shkaktuar kështu dëm DBZHËR Njësisë së Pylltarisë në Ferizaj, në vlerë prej 324,00Euro.

- me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4, 41, 43, 46 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 365 dhe nenit 495 par. 1 të KPPRK-së, e gjykon me:

DËNIM ME GJOBË

Me dënim në gjobë në shumë prej 200 (dyqindë) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në forma të tjera sipas nenit 46 të KPK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1 (një) ditë burg.

Obligohet i pandehuri qe te dëmtuarës Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural zyra në Ferizaj, ti kompensoj dëmin ne vlerën prej 324.00€ në afatin prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € në afat prej 30 dite nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën, PP/II.nr.2313-6/2017, e dt. 21.11.2017, ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajit, për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së, dhe njëherit gjykatës i ka kërkuar edhe dhënien-lëshimin e urdhrin ndëshkimorë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal dhe shkresat tjera të lëndës, lidhur me arsyeshmërinë e aktakuzës në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtet ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata duke shqyrtuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës, vlerëson se ka prova të besueshme, lidhur me bazueshmërinë e Aktakuzës në drejtim të vërtetimit të fakteve dhe erdhi në përfundim se i pandehuri vërtet e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 495 të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPRK-së dhe konform nenit 495 par. 1 të këtij kodi mori vendim që të pranoj propozimin për dhënien e urdhrin ndëshkimorë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Mundësia e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 46 të KPRK-së.

Gjykata ka obliguar te pandehurin qe te dëmtuarës Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural zyra n; Ferizaj, ti kompensoj demin ne vlerën prej 313,65 €. në afatin prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të paushallit është marrë në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPP.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr.2969/17 e dt. 12.12.2017

Gjyqtari i vetëm gjykues
Mustaf Tahiti



KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhri ndëshkimorë merr formën e prerë.